

Perëndia Është Me Ne (seria e Krishtlindjes, pjesa 3 nga 4)

Përshëndetje!

Gjatë dy të dielave të kaluara kemi qenë duke parë një varg nga Bibla:

Mateu 1:23 *"Ja, virgjëresha do të mbetet shtatzënë dhe do të lindë një djalë, të cilit do t'i venë emrin Emanuel, që do të thotë: "Perëndia me ne"!"*

Kemi folur se si ta ndjesh praninë e Perëndisë në stinë të ndryshme të jetës, sepse jeta ka uljet dhe ngritjet e veta.

Kënaqemi në majë të malit—por e njohim Perëndinë në luginat e jetës.

Javës së shkuar pamë që Perëndia është me ne në shkretëtirë. Kur je në shkretëtirë, a thotë Perëndia të vërtetat e Tij me zë të lartë apo me pëshpërime?

Sot dua të shikojmë: Si ta ndjejmë që Perëndia është me ne në stuhi, në kohë stuhie?

Një njeri po thoshte, 'E di si është jeta: ose sapo ke kaluar një stuhi, ose po të vjen një rrotull, sepse jeta është e tillë.' Kjo nuk është shumë inkurajuese por është e vërtetë. Por pyetja që na mundon në kohë të tilla është: Ku është Perëndia kur jam në mes të një stuhie?

Ajo që më duket çudi, në Amerikë p.sh. stuhive/uraganeve të mëdha u vënë emra njerëzish. Njëri quhej Urangani Harli, tjetri Urangani Irma. Prit t'ju them diçka të veçantë: më përpara uraganët në USA merrnin emrin sipas zonave, por në vitin 1954 meteorologët filluan duke u vënë stuhive emrat e grave të veta ose të dashurave. Sa budallallëk! Më imagjino mua meteorolog, mos më imagjino me detaje se nuk ngjaj me atë që jep kohën te Top Channel. Por imagjino, unë jam meteorolog dhe vij në shtëpi dhe i them gruas sime: 'Grua, po vjen një uragan i madh këto ditë, është në Itali sonte, nesër vjen në Shqipëri, po e gjete çfarë emri i kam vënë, e gjete, i kam vënë emrin tënd. Si të duket si emër?'

'Si më duket?! Ta tregoj unë uraganin ty!'

Deri në vitin 1979 ishte kështu, se pastaj fituan gratë të drejtat e barabarta dhe stuhive filluan duke iu vënë edhe emra burrash.

Nëse i krahasojmë me stuhitë e jetës, ka gjasa ti je në një stuhi tani dhe po tundohesh t'i vësh një emër. Çfarë emri do t'i vësh? Stresi? Prit se ky emër është i zënë. Do doja ta kaloja sa më parë këtë stuhi financiare, këtë stuhi

sherresh pa lidhje, këtë stuhi spitali dhe virozash, këtë stuhi... Çfarë stuhie po kalon?

Si ia bën ti kur je mes një stuhie? Shumica, fatkeqësisht, ia vënë fajin Perëndisë ose vënë në dyshim Perëndinë.

Ku është Perëndia? Pse e lejoi të më ndodhte kjo?

Pse Perëndia nuk bën diçka? Perëndi, pse duhet të kaloj unë një tension të tillë, pse nuk ma kurseve këtë furtunë? Ajo që do të përsëris shpesh është: Kur vijmë stuhitë, kurrë mos e dysho praninë e Perëndisë. Mos lejo praninë e stuhisë të të bëjë të dyshosh praninë e Perëndisë.

Do të shikojmë te Veprat 27, ku disa burra janë në mes të një stuhie shumë të madhe dhe të çmendur, stuhi që vazhdoi për disa ditë. Ekuipazhi u tmerrua, po hidhnin çdo gjë që peshonte në det për ta lehtësuar anijen dhe menduan: kaq e pati jeta e tyre.

Veprat e Apostujve 27:20 *'Dhe, duke qenë se prej shumë ditësh nuk dukeshin as dielli as yjet, dhe furtuna po tërbohej, humbi tashmë çdo shpresë shpëtimi.'*

Furtuna po tërbohej, dhe për shkak të saj, humbi çdo shpresë.

Më mbeti mendja te kjo, sepse e has herë pas here nga bisedat me njerëz të ndryshëm: 'Më ka humbur çdo shpresë.'

Më kanë humbur shpresat për këtë shkollë, më kanë humbur shpresat te kjo punë, më kanë humbur shpresat te kjo martesë, lidhje. Më kanë humbur shpresat, ai s' do ta kalojë dot këtë sëmundjen që i ka rënë. Më kanë humbur shpresat, nuk besoj se do të kemi fëmijë. Më kanë humbur shpresat, po nuk ika nga Shqipëria nuk bëj dot përpara.

Veprat e Apostujve 27:21 *'Edhe, mbasi kishin mbetur shumë kohë pa ushqim, Pali u çua në mes të tyre dhe tha: "O burra, po të më kishit dëgjuar dhe të mos ishit nisur nga Kreta, do t'i ishim shmangur këtij rreziku dhe kësaj humbjeje.'*

Kur dëgjon këtë, si të vjen? Sa herë e ke dëgjuar këtë shprehje, 'Po të më kishe dëgjuar mua, atë thashë mos?' Pali, sado që ishte i fortë shpirtërisht, përsëri ishte njeri. 'A ju thashë të mos niseshit?' Ndokush mund të thotë, 'Qenkam edhe unë si Pali.' Jo, jo, kjo nuk është ana e fortë e Palit, kjo është ana njerëzore. Nuk duhet ndonjë forcë e madhe për të thënë, 'A të thashë?

Pse nuk më dëgjove?’

Përse ishin ata në mes të furtunës? Ishin për faj të tyre, sepse vendosën të lundronin edhe pse rrethanat kishin rrezik. A e ke vënë re sa shpesh, të krishterët, ia vënë fajin djallit për situatat, rrethanat ku janë? A e di çfarë? Disa situata nuk kanë lidhje fare me djallin, satanin. Ti je aty ku je, sepse ia fute kot, more një vendim koti. Disa herë ti je në mes të një stuhie financiare sepse kur kishe lekë i prishe pa llogari fare, rrush e kumbulla, s'ka faj askush.

Disa herë je në mes të një stuhie sepse ke qenë përtac. Nuk e ka fajin djalli se ngele në provim. E kanë fajin kafet e shumta dhe që nuk u thojë dot ‘jo’ shokëve dhe shkove në party deri vonë dhe të nesërmen kishe provim dhe nuk dije asgjë.

Disa herë je në stuhi sepse të gjithë të thanë, *mos dil me filanin, nuk bën ai për ty*. Prindërit të thanë *mos*, shokët të thanë *mos*, të gjithë të thanë *mos*, madje edhe ajo fallëxhorja te plazhi që të shikon dorën të tha *mos*, po bëj shaka. Por ti the, 'Po jo, se shiko sa i mirë që është, është çun me botë.' Po po, ka aq shumë botë sa të shkatërrojë botën tënde krejt. Ti s'pyete asnjë dhe bëre si deshe vetë dhe tani je në mes të stuhisë.

Te kjo historia jonë, janë disa persona që ishin në furtunë, por nuk varej nga ata që ndodheshin aty. Ishin pjesë e ekuipazhit dhe kapiteni tha, ‘Do nisemi,’ dhe do niseshin, çfarëdo që të thoshin nuk ndryshonte gjë.

Sa nga ju u është dashur të kaloni nëpër stuhi për shkak të dikujt tjetër? Nëse ai personi është këtu mos e trego me gisht, thjesht po e them për muhabet.

P.sh. kur ishe fëmijë, ti ishe në stuhi sepse u ndanë prindërit, nuk ishte për fajin tënd. Ose puna ku ishe bëri shkurtime sepse nuk e menaxhuan mirë buxhetin dhe je në stuhi për shkak të shefit, pronarit tënd. Ose i besove dikujt, të pati dhënë fjalën, ti e besove por një ditë me diell ai vendosi të kundërtën dhe ti je në stuhi.

Cilado qoftë situata pse je në stuhi, në ditë të tilla ty të ka humbur çdo lloj shprese sepse stuhia nuk po ndalon.

Kur vijnë stuhitë kurrë mos e dysho praninë e Perëndisë. Mos lejo praninë e stuhisë të bëjë të dyshosh praninë e Perëndisë.

Veprat e Apostujve 27:22-23 *'Dhe tani ju këshilloj të mos e humbni toruan sepse asnjë shpirt nga ne nuk do të humbasë, përveç anijes. Sepse këtë natë*

m'u shfaq një engjëll i Perëndisë, të cilit unë i përkas dhe të cilit unë i shërbej,'

Prit pak, çfarë thotë Pali? 'Isha në mes të stuhisë dhe një engjëll i Perëndisë u shfaq, më qëndroi pranë.' Ne nuk i shikojmë me sy, por ka engjëj të Perëndisë në këtë dhomë. Unë besoj, se e thotë Bibla, bota nuk është vetëm kaq sa shikojmë ne me sy fizikë. Ka një botë frymërore që ekziston rreth nesh dhe ne nuk e shikojmë dot. Ka luftë mes engjëjve dhe demonëve që ne nuk e shikojmë dot me sy.

Mund të ketë engjëj këtu rreth e qark meje. Do ishte qejf t'i shikoje me sy. "Ça ke bo shoku, mirë po ti, uee sa i madh qenke ti, plas këtu shoku, prit se jemi të njohur ne të dy, e bëjmë kështu si cool boys." Nuk e di jo, nuk e di.

Ajo që dimë është se mes stuhisë, prania e Perëndisë është aty me ty. Dhe nuk e ke idenë se në ç'formë është Perëndia me ty në stuhi. Mund të jetë afër teje me anë të një engjëlli që të mbron. Ai banon në ty me anë të Frymës së Shenjtë. Ai shkon para teje për të të udhëzuar sepse e di çfarë do të ndodhë nesër dhe gjithë vitin që po vjen, edhe pse viti s'ka filluar akoma. Ai dëgjon lutjet e tua. Ai të ngushëllon në kohë dhimbjesh. Ai të drejton kur humb drejtimin.

Perëndia mund të jetë me ty në shumë, shumë forma. Pali tha, 'Në mes të stuhisë një engjëll i Perëndisë m'u shfaq.' Ja si tha një herë tjetër Pali:

2 Timoteut 4:16-17 *'Në mbrojtjen time të parë në gjyq askush nuk qe me mua, por të gjithë më lanë; kjo të mos u numërohet për faj. Por Zoti më ndenji pranë dhe më dha fuqi, që me anën time predikimi i ungjillit të kryhej plotësisht dhe ta dëgjonin të gjithë johebrenjtë; dhe unë shpëtova nga goja e luanit.'*

Ajo që del qartë në Shkrim është, nuk ka rëndësi se çfarë po kalon në jetë, Perëndia është aty me ty dhe është aty për të të dhënë fuqi. Davidi në Dhjatën e Vjetër tha:

Psalmet 16:8 *'Unë e kam vënë vazhdimisht Zotin përpara syve të mi; duke qenë se ai rri në të djathtën time, unë nuk do të hiqem kurrë nga vendi.'*

Ka shumë rëndësi se kush është afër teje. Kur ti e kupton që Perëndia është me ty, të ndryshon qëndrimin, të ndryshon botën, të ndryshon emocionet, të forcon besimin, të qetëson mendjen.

Kur çunat e mi kanë stërvitje dhe më shikojnë mua afër, shkëlqejnë më

shumë. Djali im kishte një pjesë me fizarmonikë te festa e shkollës të mërkurën dhe e dinte përmendësh gjithë pjesën. Por po ta shikosh në video, u ngatërrua sepse po na kërkonte neve nëpër audiencë me sy dhe s'po na shikonte sepse kishte shumë njerëz. 'Rubi, pse u ngatërrove?' 'Po ju kërkoi ju, po s'po ju shikoja.'

Ka shumë rëndësi se kush është me ty në stuhi. Ne themi 'A do vish me mua të shkojmë në filan vend?', dhe ndihemi më të sigurt. Dhe e njëjta gjë është me besimin, kur ti e di se Perëndia është me ty, edhe pse po kalon stuhi, kjo të forcon dhe nuk ke frikë.

Në Dhjatën e Re, është një varkë tjetër në mes të furtunës. Ishin dishepujt e Jezusit në mes të detit të Galileës dhe ishte një stuhi e madhe. E bukura e kësaj historie ishte se Jezusi ishte bashkë me dishepujt në varkë, por ishte në gjumë. Dishepujt u frikësuan për vdekje. 'Jezus, zgjohu, po vdesim, do mbytemi. Bëj diçka!' Jezusi çohet dhe u thotë, 'Po pse jeni kaq besimpak?' Pastaj i flet stuhisë, erës dhe bëhet qetësi e madhe. Çfarë ndodhi? Çdo gjë u qetësua sepse Jezusi ishte në varkë.

Qetësia jonë nuk vjen kur nuk kemi stuhi në jetë, kur mundohemi t'i sheshojmë gjërat, jo, jo, qetësia vjen kur ti e di kush është afër teje, kur Jezusi është afër teje.

Kur ti vendos të ndjekësh Jezusin, nuk do të thotë që jeta do shkojë përditë vaj dhe s'do kesh sfida dhe vështirësi. Por qetësia vjen kur kapesh pas premtimit të Tij: 'Unë jam me ty, jam përkrah teje.'

Veprat e Apostujve 27:23-25 *'Sepse këtë natë m'u shfaq një engjëll i Perëndisë, të cilit unë i përkas dhe të cilit unë i shërbej, duke thënë: "Pal, mos druaj, ti duhet të dalësh para Cezarit; dhe ja, Perëndia ty t'i ka dhënë të gjithë ata që lundrojnë me ty". Prandaj, o burra, kini zemër të gëzuar, sepse unë besoj në Perëndinë se do të ndodhë pikërisht ashtu siç m'u tha.'*

Me fjalë të tjera, Pal, ti do të dalësh para Cezarit. Ti nuk do të biesh në këtë betejë, sepse Perëndia ka shumë beteja të tjera që ti duhet të shkosh për të luftuar. Ndoshta kjo mund të jetë për dikë: 'Ti nuk do të biesh në këtë betejë, në këtë stuhi sepse Perëndia ka shumë më shumë gjëra për të bërë me ty dhe nëpërmjet teje. Ai nuk ka mbaruar me ty. Perëndia do të sjellë shumë e më shumë njerëz që ti mund t'i ndihmosh, t'u japësh dashuri. Ti do të jesh bekim për shumë. Ti nuk do të rrëzohesh, anija mund të mbytet por jo ti.'

Dhe e bukura është, se kur ti kalon stuhi, Perëndia nuk i shkon kot përvojat

që ke kaluar ti. Ai të përgatit ty, që kur dikush tjetër të kalojë nëpër të njëjtën stuhi, ti të kesh mundësi ta ndihmosh atë person.

Kjo është e bukur. Çdo stuhi ka një qëllim. Nëpërmjet stuhisë, Perëndia po të forcon, por edhe po të përgatit, po të forcon rrënjët dhe shpejt vjen dita që Perëndia të të përdorë ty të ndihmosh dikë tjetër që po kalon të njëjtën stuhi si ty.

Veprat e Apostujve 27:25 *'Prandaj, o burra, kini zemër të gëzuar, sepse unë besoj në Perëndinë se do të ndodhë pikërisht ashtu siç m'u tha.'*

Prandaj, o burra, o goça, o trima, o trimëresha, kini zemër të gëzuar, mos u trishtoni, mos u zhgënjëni, besoni fort. Pali tha, 'Unë besoj në Perëndinë, unë besoj që kështu do ndodhë, si më ka thënë Perëndia.'

Besimi nuk varet te ajo që shikoj—por çfarë ka thënë Perëndia.

Nuk kam besim te anija, kam besim te Ai që komandon erën dhe dallgët. Nuk kam besim te varka, kam besim te Ai që ka krijuar pemët me të cilët u bë varka.

Kam besim që Ai do të sigurojë, kam besim që Ai do të shërojë, kam besim që Ai është me mua në mes të stuhisë. Unë kam besim te Perëndia dhe do të ndodhë siç thotë Ai.

Sepse në fund të fundit, kush mund ta kontrollojë stuhinë? Kush mund ta caktojë nivelin e stuhisë, sa e fortë do të jetë, sa do të zgjasë?

Ti nuk e kontrollon dot se çfarë do të thonë njerëzit për ty. Ti nuk e kontrollon dot çfarë mendojnë të tjerët për ty. Por ti mund të kontrollosh se ku do të besosh dhe ku do ta vendosësh besimin. Besimi im është te Ai që ka krijuar erën dhe dallgët. Besimi im është te Perëndia. Kam besim te një Perëndi i tillë, që çfarëdo të thotë Ai, ashtu do të ndodhë. Kush është Perëndia për ne? Përtypi këto vargje:

Psalmet 46:1-3 *'Perëndia është për ne një strehë dhe një forcë, një ndihmë gjithnjë e gatshme në fatkeqësi. Prandaj ne nuk do të kemi frikë edhe sikur toka të luajë dhe malet të hidhen në mes të detit, dhe ujërat e tij të tërbohen dhe të shkumojnë, dhe malet të dridhen në fryrjen e tij. (Sela)'*

Për shkak se e di kush është Perëndia, unë nuk do të kem frikë, edhe po e humba këtë punë, edhe po nuk vazhdoi më kjo lidhje, edhe po mori kot ekonomia, edhe po mori kot politika, unë prapë s'do të kem frikë. Pse? Sepse

Ai është me mua. Kurrë s'do të më braktisë, kurrë s'do të më lërë vetëm, kurrë s'do të më harrojë. Nëse kam Perëndinë, i kam të gjitha të tjerat që më duhen. Ai është streha ime. Ai është forca ime. Ai është ndihma ime. Ai është energjia ime. Ai është drejtësia ime. Ai është si një mik më i afërt se një vëlla. Ai është shkëmbi im. Ai është buka e jetës. Ai është dera për jetën e sigurt. Ai më udhëzon hapat. Ai është aty në kohë nevojë për mua. Ai është qetësia ime.

Qetësia nuk ndodh kur s'ka stuhi, ndodh kur Jezusi është afër meje. *"Ja, virgjëresha do të mbetet shtatzënë dhe do të lindë një djalë, të cilit do t'i venë emrin Emanuel, që do të thotë: "Perëndia me ne"."* Prandaj...

Kur vijnë stuhitë kurrë mos e dysho praninë e Perëndisë. Mos lejo praninë e stuhisë të bëjë të dyshosh praninë e Perëndisë.

Stuhitë janë pjesë e jetës. Por qetësia, paqja e vërtetë është në praninë e Emmanuel, Perëndia me mua. Nuk e kam besimin te ajo që shikoj, por te ajo që ka thënë Perëndia. Dhe Perëndia thotë, 'Nuk ka stuhi që të ul poshtë ty. Ji i qetë, Unë jam me ty.'

Lutemi bashkë!

Lutja e shpëtimit!